



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

**RAPORT I PUNËS
PËR VITIN 2014**

ZYRA QENDRORE E FEDERATËS SË SINDIKATAVE TË SHENDETËSISË SË KOSOVËS

Janar

Përmbajtja

1. Hyrje_____
2. Aktivitetet e Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës_____
3. Komunikata për media të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës_____
4. Aktivitete e FSSHK-së në: tryeza të rrumbullakëta, trajnime , seminare_____
5. Aktivitete të FSSHK-së me Ministrin e Shëndetësisë_____
6. Aktivitetet në lidhje me Marrëveshjet e mirëkuptimit_____
7. Aktivitetet e realizuara në mes të FSSHK-së dhe Drejtorit të SHSKUK-së_____
8. Hapja e Zyrës Qëndrore të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës_____
9. Aktivitete të FSSHK-së me punëtorët shëndetësorë_____
10. Aktivitetet të FSSHK-së në kuadër të Projektit për Ligjin e Sigurimeve Shëndetësore_____
11. Aktivitete të FSSHK-së në komisione të ndryshme_____
12. Aktivitete të FSSHK-së me strukturat politike_____
13. Aktivitetet e FSSHK-së me Sindikatat vendore_____
14. Aktivitetet të realizuar nga FSSHK me OJQ vendore dhe ndërkombëtare_____
15. Aktivitetet me subjektet afariste për përfitim të beneficioneve shtesë për anëtarësinë e gjerë:_____
16. Aktivitetet e FSSHK-së në lidhje me zgjedhjet sindikale:_____
17. Aktivitetet të tjera :_____

HYRJE

Duke u mbështetur në detyrimet që rrjedhin nga Statuti i FSSHK-së mbi kompetencat e titullarëve të lartë të Federatës, e paraqesim këtë raport mbi aktivitetin sindikal për vitin 2014, gjegjësisht periudhën nga muaji Janar/2014 deri në muajin Dhjetor / 2014.

Në aspektin e politikave sindikale, në pozita përkatëse, duke u përpjekur që t'i përgjigjemi gjendjes momentale në terren kemi zhvilluar një sërë aktivitete.

Andaj, me qëllim të detajizimit të aktiviteteve të realizuara për këtë periudhë paraqesim të dhënat mbi këto aktivitete për vitin 2014.

Që nga Janari I vitit 2014 janë realizuar këto aktivitete të ndara në disa kapituj të cilat pasqyrojnë punën e FSSHK-së në aspektin narrative.

1. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjashtë(6) mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme të Kryesisë :

Me 27.01.2014 -Në Zyrën e Sindikatës së Gjakovës është mbajtur mbledhja e Kryesisë së FSSHK-së . Ne kete mbledhje jane diskutuar qeshtjet me rendesi dhe interes te Federates, ku jane nxjerre edhe disa vendime mbi hapjen e konkursit për Zyrtar Ligjor në Zyrën e Regionit Sindikal Prishtinë,si dhe Vendimi mbi pagesën e Zyrtarëve ligjor për punën me financa.

Me 11.03.2014- Në zyrën Qëndrore është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së FSSHK-së . Në këtë mbledhje janë diskutuar aktivitetet e FSSHK-së në mes të dy mbledhjeve si dhe aktivitetet e Regjioneve Sindikale.

Me 05.05.2014- Në zyrën Qendrore është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së FSSHK-së .Ku pas miratimit të procesverbalit dhe raportimit mbi aktivitetet e zhvilluara të anëtarëve të Kryesisë është proceduar me Vendimin për rritjen e pagave dhe stimulimeve për 25% në bazë të vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Me 02.07.2014- Në Zyrën Qëndrore është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së FSSHK-së,ku anëtarët e Kryesisë u njoftuan në lidhje me Projektin mbi pajisjen me kartela të financuar nga Bashkimi Evropian e cila implementohet nga OJQ "IKS",pas diskutimit Kryesia mori Vendim që të gjithë anëtarët të pajisen me Kartela në mënyrë që të përfitohen beneficione nga marrëveshjet e lidhura me subjektet afariste.Gjithashtu në këtë mbledhje u mor Vendim mbi procedimin me padi ndaj gazetës Zëri në emër të Kryetarit të FSSHK-së dr. Blerim Sylja.

Me 05.09.2014 -Në Zyrën Qëndrore është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së FSSHK-së.Në të cilën është diskutuar procesi i përzgjedhjes së drejtorëve të njësive përbërëse të SHSKUK-së.

Me 14.11. 2014 -Në Zyrën Qëndrore është mbajtur mbledhja e rregullt e Kryesisë së FSSHK-së ku është diskutuar për gjendjen e përgjithshme në shëndetësi dhe situata e krijuar pas ngërqit politik.

Me 16 .12. 2014 -Në Zyrën Qëndrore është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Kryesisë së FSSHK-së.Mbledhja e jashtëzakonshme është thirrur me qëllim të njoftimit të Kryesisë dhe anëtarësisë së gjerë me gjendjen e krijuar pas deklaramit të Ministrit të ekonomisë si dhe Kryeministrit të vendit mbi mos rritjen e pagave.Në këtë mbledhje u morën disa vendim si Vendimi mbi aprovimin e kërkesës nga Petrol Company në lidhje me zbritjen në derivate për 0,025 cent për litër për të gjithë anëtarët e FSSHK-së .

2. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka lëshuar (9) komunikata për media dhe (5) konferenca për media për çështje të ndryshme si dhe 55 intervista në gazeta ditore:

Me datë 08.01.2014-Federata e Sindikatave të shëndetësisë së Kosovës ka lëshuar komunikatë për medie në lidhje me shkarkimin e Dr. Nijazi Gashit nga pozita e Drejtorit të QKUK-së.

Me datë 14.04.2014-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka lëshuar reagimin dhe sqarim për opinionin për shkrimin e gazetës ditore "Zëri".

Me datë 06.06.2014- Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës-FSSHK shpreh keqardhjen me rastin e shpërthimit të ndodhur në Termocentralin A familjarëve të viktimave të këtij shpërthimi si dhe i bashkohemi thirrjes së Sindikatës së KEK-ut për përmirësimin e kushteve të punës dhe sanimin e rrezikut permanent i cili i kanoset punëtorëve në këtë Termocentral.

Me 11.07.2014- për situatën e krijuar pas Vendimit të Asambles Komunale për Tjetërsimin e pronës së QKMF-së në Gjakovë si dhe gjendjen në përgjithësi të punëtorëve shëndetësor të kësaj QKMF-je.

Me 13.08.2014-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka lëshuar Komunikatë për medie pas reagimit të disa mediave se Komisioni për përzgjedhje të Drejtorëve ka bërë lëshime në lidhje me të intervistuarit.

Me 09.09.2014-Federata e Sindikatave të shëndetësisë ka lëshuar Komunikatë për shtyp në lidhje me sqarimin e opinionit për procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të njësive përbërëse të SHKUK-së

Me datë 05.09.2014 Kryetari i FSSHK-së me Kryetarin e Komunës së Prishtinës z.Shpend Ahmetin,Drejtorin e DSHMS dhe përfaqësuesen e Regjionit të Prishtinës, Kryetari i Sindikatës së QKMF –Prishtinë kanë mbajtur një konferencë për medie ku është pasqyruar bashkëpunimin në mes të FSSHK-së dhe Komunës së Prishtinës si dhe përmbushja e kërkesave të FSSHK-së.

Me datë 12 Dhjetor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Sylja dhe Nënkryetari i FSSHK- së z. Blerim Delija kanë realizuar një takime me Përfaqësuesin e Sindikatës së arsimit, me ç'rast kanë dal më një komunikatë për media duke shprehur qëndrimin e sindikatës së arsimit, shëndetësisë, policisë,juridikaturës.

Me datë 16 Dhjetor 2014 Është organizuar Konferencë për media nga sindikatës e shëndetësisë, arsimit, policisë , dhe administratës lidhur me vendimin e Qeverisë për mos ngritjen e pagave me ç’rast sindikatat shpalosën para opinionit kërkesat e tyre.

Me 24 Dhjetor-Pas takimeve me Shefat e Grupeve Parlamentare të Partive Politike të përfaqësuar në Parlamentin e Kosovës,Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka lëshuar Komunikatë për media me qëllim të sqarimit të opinionit në lidhje me zhvillimin e takimeve dhe kërkesës për takim me Kryeministrin.

Kryetari i FSSHK-së ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha televizionet publike vendore në të cilat ka mbrojtur qëndrimet e FSSHK mbi ngjarjet e përgjithshme në sektorin e shëndetësisë,politikave sociale,Kontratës Kolektive,vlen të theksohet pjesëmarrja në RTK-Imazh,Klan kosova-Info Magazin,KTV-Program i mëngjesit,RTV21-Emisioni Click,RTK3-Nën vëzhgim dhe një sërë emisionesh të tjera si i intervistuar.

3. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka realizuar një(1) Konferencë Rajonale, trajnime, seminare:

Me 03.06.2014 Federata e Sindikatave te Shëndetësisë së Kosovës ka organizuar Konferencë Rajonale me temën “Migrimin i punëtorëve shëndetësor” në “Hotel Sirius” ku kanë qenë pjesëmarrës Përfaqësuesit nga Tehy, Përfaqësues nga EPSU/PSI si dhe Shqipëria , Bulgaria, Romania , Maqedoni, Mali i Zi, ndërsa nga përfaqësuesit vendor në këtë Konferencë kanë marrë pjesë Ministri i Shëndetësisë, , Kryetarja e Odës së Mjekëve , Drejtori i SHSKUK-së, Kfori si dhe përfaqësues nga organizatat jo qeveritare.Gjatë kësaj Konference u shpaluan të dhënat në lidhje me migrimin e punëtorëve shëndetësor të realizuara nga FSSHK përmes pyetësorëve të zhvilluar me Studentë të Fakultetit të Mjekësisë dhe punëtorë shëndetësor.

Me datë 18.09.2014 deri me 20.09.2014 Federata ka organizuar trajnim për grupin e parë të liderëve sindikal me temën : kontrata kolektive , dialogu social dhe komunikimi masivë , të ligjëruar nga prof. Minello Mano në Shqipëri,trajnimi ka zgjatur dy ditë dhe pjesëmarrësit në fund janë pajisur me Qertifikata.

Me datë 23.10.2014 deri me 25.10.2014. Federata ka organizuar trajnim për grupin e dytë të lider sindikal dhe zyrtarëve ligjor me temën : kontrata kolektive , dialogu social dhe komunikimi masiv , të ligjëruar nga prof. Minello Mano në Shqipëri.

Nga datë 03 deri 05 dhjetor 2014 është mbajtur trajnim për lider të forumit Rinor të organizuar nga FSSHK-ja në Shqipëri me temën : kontrata kolektive , dialogu social dhe komunikimi masiv , të ligjëruar nga prof. Minello Mano.

Me datë 05 Dhjetor 2014 Nënkyetari i Fsshk-së z. Blerim Delija dhe përfaqësuesja e organizatës "IKS" Abi Dodbiba ka vizituar pjesëmarrësin në trajnim të Forumit Rinor të mbajtur në Shqipëri.

4. Aktivitete të realizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me Ministrin e Shëndetësisë:

Me 09.01.2014 Kryetari i Federatës Dr. Blerim Sylja ka zhvilluar takim me Ministrin e Shëndetësisë Dr. Ferid Aganin, në Ministrinë së Shëndetësisë.

Me 09.01.2014 Një delegacion nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës i përbërë nga Nënkyetarët e Federatës Z.Blerim Delija dhe Dr. Xhemail Selmani ka realizuar një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Gani Shabani në MSH.

Me 20.02.2014 Një delegacion nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës i përbërë nga Kryetari i Federatës Dr. Blerim Sylja dhe dy Nënkyetarët e FSSHK-së Z.Blerim Delija dhe Dr.Xhemajl Selmani kanë realizuar takime me Ministrin e Shëndetësisë Dr.Ferid Agani dhe kabinetin e tij me ç'rast Ministri është zotëruar që do të përmbushë kërkesat e punëtorëve të QKUK-së.

Me 28.02.2014 Pas marrjes së informatave në lidhje me mos pagesës e kujdestarive për këtë muaj ,Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës Dr.Blerim Sylja dhe Nënkyetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë realizuar një takim me Sekretarin Permanent të MSH Z.Gani Shabani ,Zyrtarin Financiar në MSH Z.Musa Rexha si dhe Drejtorin e administratë në MSH Z.Din Kastratin kërkesa nga ana e sindikatës ka qenë e prerë që të fillohet procedura e pagesës së kujdestarive.

Pasi që ata kanë argumentuar që ka pas tejkalime të buxhetit në disa Spitale me përjashtim të Spitalit të Gjakovës dhe në QKUK, është arritur marrëveshja për përmirësimin e këtyre gabimeve e që afati kohorë është dhenë deri me 05 Mars ku do të fillohet procedura e pagesës së kujdestarive.

Me 10.03.2014 Kryetari i FSSHK-së ka realizuar takime me Ministrin e Shëndetësisë Dr.Ferid Agani me të cilin kanë diskutuar rreth zbatimit të Kontratës Kolektive Sektoriale, në disa prej institucioneve shëndetësore me theks të veçantë në Kujdesin Primar shëndetësor si dhe mosrespektimi i udhëzimeve administrative të nxjerrura nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Me 28.04.2014 Kryesia e ngushte e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës e përbërë nga Kryetari i FSSHK-së Dr. Blerim Syla, Nënkyetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija Nënkyetari i FSSHK-së Dr.Xhemajl Selmani , Kryetari i këshillit Drejtues Dr. Jahir Lajqi kanë realizuar takime me Ministrinë Shëndetësisë Dr. Ferid Agani dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 09.05.2014 Nënkyetari i Federatës Z.Blerim Deliaj ka realizuar takim pune me Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Gani Shabani.

Me 15.05.2014 Nënkyetari i Federatës Z.Blerim Deliaj ka realizuar takim pune me Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Gani Shabani.

Me 31.12.2014 Delegacioni i FSSHK-së ka zhvilluar takimin e parë njoftues me Ministrin e ri të Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Imet Rahmani.Gjatë këtij takimi është biseduar për bashkërendimin si dhe koordinimin e aktivitetet për vitin 2015.

5. Aktivitetet në lidhje me Marrëveshjet e mirëkuptimit:

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës përgjatë vitit 2014 ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Mjkeëve të Kosovës respektivisht Me 07.05.2014 Delegacioni i lartë i FSSHK-së ka pritur në takim Kryetaren e Odës së Mjekëve të Kosovës Dr.Zylfije Hundozi meqrast është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve për profesionistët shëndetësor në mes të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Odës së Mjekëve të Kosovës.

Me datë 29.10.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla ka nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit , Bashkëveprimit dhe Përfaqësimit në mes të Sindikatave SBASHK-u, SPK-ut dhe FSSHK-së.

Me datë 17 Nëntor 2014 Delegacioni i lartë i FSSHK-së ka pritur në takim Drejtoreshën e organizatës “ IKS” ZNJ. Florina Duli është nënshkruar memorandum bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve për profesionistët shëndetësor në mesë Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Organizatës IKS.

6. Aktivitetet e realizuara në mes të FSSHK-së dhe Drejtorit të SHSKUK-së:

Me 06.08.2014 Delegacioni i FSSHK-së ka realizuar takim me Drejtori e SHSKUK-së Dr.Curr Gjocaj takimi kishte karakter njoftues .

Me 13.08.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Sylja dhe Nënkryetari i FSSHK-së z. Blerim Delija kanë realizuar takim me Drejtorin e përgjithshëm të SHSKUK-së dr. Curr Gjocaj në lidhje me përzgjedhjen e Drejtorëve të njësive përbërëse të SHSKUK-së.

Me datë 21.08.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Sylja ka realizuar takim me Drejtorin e SHSKUK-së Dr. Curr Gjocaj në lidhje me situatën e krijuar pas procesit të intervistimit të kandidatëve për Drejtor të njësive përbërëse të SHSKUK-së.

Me datë 30.09.2014 Delegacion nga FSSHK-ja i kryesuar nga Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Sylja dhe Nënkryetar i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja financiare e FSSHK-së kanë realizuar takime me Drejtorin e SHSKUK-së dr. Curr Gjocaj dhe drejtorin e SHSKUK-së z. Muzafer Kalenderi në lidhje me përfshirjen në buxhet për vitin 2015 të përvojës në punë, shtesës dhe beneficioneve të tjera të parapara me Kontratë Kolektive të Përgjithshme.

Me datë 28.10.2014 Një delegacion i lart i FSSHK-së i kryesuar nga Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Sylja, Nënkryetar i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe Drejtorin e përgjithshëm i SHSKUK-së dr. Curr Gjocaj kanë vizituar Spitalin Rajonal të Ferizajt, me rastin e hyrjes në grevë të mjekëve të repartit të kirurgjisë, në shenjë revolt për pasigurinë në punë. Deri te kjo vendim i stafit të kirurgëve ka ardhur për arsye të sulmit fizik të bërë një ditë më parë ndaj kirurgut dr. Fadil Elezi, Specialist i Kirurgjisë.

Me datën 26.12.2014-Nënkryetari i FSSHK-së dhe Zyrtarja Ligjore e FSSHK-së zhvilluan një takim të përbashkët me Drejtorin e SHSKUK-së me të cilin diskutuan në lidhje me problemet të cilat Drejtorin po ballafaqohet në mungesë të kompletimit të infrastrukturës ligjore në kuadër të SHSKUK-së.

Përveq takimeve Nënkryetari i FSSHK-së ka pasur takime të vazhdueshme me Drejtorin e SHSKUK-së.

7. Hapja e Zyrës Qëndrore të FSSHK-së:

Me 08.04.2014 Është bërë hapja solemne e zyrës Qëndrore të FSSHK-së ku pjesëmarrës ishin Ministri i Shëndetësisë Dr. Ferid Agani, Zëdhënësi i MSH Z. Shemsi Veseli, Drejtorin e bordit të QKUK-së Dr. Jusuf Dedushaj dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të FSSHK-së si dhe zyrtarët ligjor dhe financiar të zyrave regjionale të FSSHK-së. Me ç'rast Ministri Agani theksoj e vlerësoi angazhimin e FSSHK-së në procesin e reformave në shëndetësinë kosovare dhe ftoi në bashkëpunim të mëtutjeshëm me qëllimin që shëndetësia kosovare të ngrihet në nivele më të larta sa i përket shërbimeve shëndetësore.

Më pas, MSH Dr. Ferid Agani dhe Kryetar i FSSHK –së Dr. Blerim Sylja ka marrë pjesë në mbledhjen e përbashkët me Këshillin Drejtues të FSSHK-së. MSH Agani prezantoi punën e tij tre vjeçare si Ministër dhe rëndësinë e reformës shëndetësore, ndër të tjera Agani shtoi, duke vazhduar bashkëbisedimin me anëtarët e FSSHK-së për çështje të rëndësishme të shëndetësisë dhe gjetjen e rrugës më të mirë për ngritjen e kënaqshmërisë reciproke mjekë –patientë.

Në emër të FSSHK-së, foli kryetari i saj dr. Blerim Sylja, i cili e vlerësoi gatishmërinë e bashkëpunimit të ministrit Agani, me FSSHK, njëkohësisht shprehu interesimin e rritjes së bashkëpunimit të mëtutjeshëm mes MSH-së dhe FSSHK-së, në kuadër të ngritjes së përgjegjësisë si profesionistë shëndetësorë, ku primare është kujdesi ndaj pacientit, por duke mos anashkalluar mbrojtjen e të drejtave të profesionistëve shëndetësorë.

8. Disa aktivitete të realizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me Punëtorët shëndetësorë:

Me datë 08.01.2014 Kryetari i Sindikatës së QKUK-së Dr. Xhemajl Selmani i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Gani Shabanit, me kërkesë për shkarkimin e Drejtorit të QKUK-së Dr. Nijazi Gashi. Pas analizimit të gjithanshëm të situatës në shëndetësinë kosovare e në veçanti asaj në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e vlerësuar si gjendje e rëndë dhe kaotike sa i përket shërbimeve shëndetësore, si pasojë e keqmenaxhimit u vendos që të kërkohet shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv të QKUK-së Dr. Nijazi Gashi.

Me 12.02.2014 Sindikata e QKUK-së ka mbajtur grevë një orësh para institucionit shëndetësor.

Me 26.02.2014 Nënkryetari i Federatës Z. Blerim Delija ka realizuar takim me Kryetarin e Sindikatës së QKMF Malishevës. Kryetari i Sindikatës në fali e informoj Nënkryetarin për probleme të cilat po ballafaqohen punëtorët shëndetësor të QKMF në Malisheve, njëherit kërkoj nga delegacion i lartë i Federatës të realizon një takim punë me Kryetari e Komunës së Malishevës Z. Ragip Begaj.

Me 14.03.2014 Një delegacion i FSSHK-së ka realizuar takime me Drejtorin e DSHMS të komunës së Prishtinës Dr. Arben Vitia dhe Përfaqësuesin e Sindikatës së QKMF –Prishtinë Z. Sherif Makollin në Zyrën Qendrore të FSSHK -së .

Me 26.06.2014 Kryetari i Federatës priti në takim Kryetarin e Sindikatës së QKMF-Gjakovë Z. Artan Hoxha ku diskutuan për problemet në mesë QKMF në Gjakovës dhe Kuvendin Komunal në Gjakove.

Me 09.07.2014 Kryetari i FSSHK-së Dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takime disa punëtor të QKUK-së të Klinikës së Stomatologjisë.

Me 11.07.2014 Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla dhe përfaqësuesi i regjionit të Gjakovës Z.Edmond Arapi kanë realizuar takim me punëtorët e QKMF Gjakove dhe Drejtorin e DSHMS të komunës së Gjakovës.

Me datë 03.09.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkyetar i FSSHK z.Blerim Delija kanë pritur na takim Kryetarin e sindikatës së QKMF Prishtinë z.Sherif Makollin dhe një përfaqësues nga zyra gjermane.

Me datë 17. 09.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla kanë prit në takim Majlinda Haxhollin për mu konsultuar lidhur me një organizimit të forumit Rinor të FSSHK-së

Me datë 29.10. 2014 Nënkyetar i Fsshk-së z. Blerim Delija ka realizuar takim me një punëtorë të QKMF-Pejë dhe zyrtaren ligjore të sindikatës në Pejë.

Me datë 30.10.2014 Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija ka pritur në takime drejtorin e Spitalit të Ferizajt dr. Gëzim Bajrami, Kryetaren e Sindikatës në Spital të Ferizajt znj. Halim Zymberi lidhur me problematikën e krijuar atje.

9 .Aktiviteti të FSSHK-së në kuadër të Projektit për Ligji i Sigurimeve Shëndetësore

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Solidar Suisse me seli në Prishtinë Federata e Sindikatave të Shëndetësisë përgjatë vitit 2014 ka realizuar projektin mbi Vlerësimin e preferencave të punëtorëve shëndetësor dhe vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore karshi zbatimit të skemës së sigurimeve shëndetësore respektivisht implementimin e Ligjit për Sigurime shëndetësore.

Rreth këtij projekti janë përcaktuar 4 objektiva me të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme si përpilimi I Pyetësorit nga ekspert vendor,takime me menaxhmente të insitucioneve shëndetësore,zhvillimi I Listës kontrrolluese të insitucioneve publike shëndetësore.

Në këto aktivitetet janë përfshirë të gjitha insitucionet shëndetësore të nivelit primar sekondar dhe tericar.

Me datë 23.09.2014 , Nënkyetari i Federatës z. Blerim Delija ka realizuar takime me drejtor dhe shefa te reparteve të Spitalit Rajonal të Pejës dhe QKMF në Mitrovicë , duke

zhvilluar pyetësor lidhur me objektiven B –Vlerësimi i preferencave të punëtorëve shëndetësor mbi Ligjin e Sigurimeve shëndetësore, në kuadër të projektin me “Solidar Suisse”.

Me datë 24.09.2014 , Nënkyetari i Federatës z. Blerim Delija ka realizuar takime me drejtor dhe shefa te reparteve të Spitalit Rajonal në Gjakovë dhe në Spitalin Rajonal Prizren, duke zhvilluar pyetësor lidhur me objektiven B –Vlerësimi i preferencave të punëtorëve shëndetësor mbi Ligjin e Sigurimeve shëndetësore, në kuadër të projektin me “Solidar Suisse”.

Me datë 25.09.2014 Është mbajtur trajnimi i hulumtuesve për pyetësorin në kuadër të projektit me “Solidar Suisse”, në zyrën qendrore të FSSHK-së.

Me datë 02.10.2014 Është mbajtur trajnimi i hulumtuesve për pyetësorin në kuadër të projektit me “Solidar Suisse”, në zyrën qendrore të FSSHK-së.

Me datë 15 Tetor 2014 , Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja ligjor e FSSHK-së Nora Murataj kanë realizuar një takime me partnerët e “Solidar Suisse”.

Me datë 03.11.2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja ligjore e FSSHK-së kanë realizuar takim me drejtorin e SHSKUK-së dr. Curr Gjocaj dhe drejtorin e QKMF në Prishtinë me ç’rast e kanë zhvilluar një pyetësor për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Me datë 04 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija , Përfaqësuesi i Regjionit të Gjilanit dr. Naim Sahiti dhe zyrtarja ligjor e Federata dhe zyrtari ligjor i zyrës në Gjilan, kanë realizuar takime me drejtorin e Spitalit Rajonal të Gjilanit ku kanë zhvilluar një pyetësor për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Me datë 05 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija ,Përfaqësuesi i Regjionit të Gjakovës z. Edmon Arapi dhe zyrtarja ligjor dhe administrative kanë realizuar takim me drejtorin e Spitalit Rajonal të Gjakovës.

Me datë 05 Nëntor 2014 Delegacion nga FSSHK-ja i kryesuar nga Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe Përfaqësuesi i Regjionit të Pejës z. Bujar Agusholl dhe zyrtarët ligjor kanë realizuat takim me drejtorin e Spitalit Rajonal të Pejës, pastaj delegacion nga FSSHK-ja se bashku me Kryetari e Sindikatës së QKMF në Pejë dr. Jahir Lajqi kanë realizuar takim me drejtorin e QKMF në Pejë ku është zhvilluar një pyetësor për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Me datë 06 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija ,Përfaqësuesi Regjional i Prizrenit dr. Selman Muqaj dhe zyrtarët ligjor nga FSSHK-ja kanë realizuar takime me drejtorin e Spitalit Regjional të Prizrenit.

Me datë 06 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija ,Përfaqësuesja e Regjionit Ferizaj znj. Tevide Ymeri , Kryetarja e Sindikatës të Spitalit Ferizaj znj. Halime Zymberi dhe zyrtarët ligjor nga FSSHK-ja kanë realizuar takim me Drejtorin e Spitalit Rajonal të Ferizajt dhe drejtorin e QKMF në Ferizaj ku kanë zhvilluar një pyetësor për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Me datë 12 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federata z. Blerim Delija kanë realizuar takime me përfaqësuesit e “Solidar Suisse”.

Me datë 19 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-ja i përbërë nga Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija ,Përfaqësuesi Regjionit të Mitrovicës z. Skender Uka , Kryetari i Sindikatës të Spitalit Vushtrrisë dr. Fazli Jetullahu dhe Kryetari i Sindikatës së QKMF Vushtrri dr. Nexhmedin Rashica dhe zyrtarët ligjor nga FSSHK-ja kanë realizuar takim me drejtorin e Spitalit Rajonal të Vushtrrisë dhe drejtoreshën e QKMF në Vushtrri pastaj me drejtorin e Spitalit Rajonal Mitrovicë dhe drejtorin e QKMF Mitrovicë ku kanë zhvilluar një pyetësor për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Me datë 27 Nëntor 2014 Një delegacion nga FSSHK-së i kryesuar nga Kryetari i FSSHK Dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takime partnerët e Solidar Suisse si Drejtoreshën Znj. Syzana Baja, dr. Ilir Hoxha, z. Albani Fejza .

10 . Aktivitete të realizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në komisione:

Me 24.02.2014 Është mbajtur komisioni intervistues pran Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovë për Zyrëtar Ligjonë Regjionit te Prishtinës.

Me 24.02.2014 Është mbajtur komision pran Federatës për përzgjedhjen e ofertës lidhur me blerjen e kuzhinës për zyrën qendrore të FSSHK-së.

Me 24.02.2014 Është mbajtur komision pranë Federatës për blerjen e inventarit për Zyrën Qëndrore të FSSHK-së.

Me 27.06.2014 Është mbajtur komision për pranimin në punë të zyrtar ligjore në zyrën regjionale të Sindikatës në Prizren.

Me 18.09.2014 është mbajtur komisioni për përzgjedhjen e transportit për pjesëmarrësit e grupit të parë në Trajnim të liderëve sindikal.

Me 18.09.2014 është mbajtur komisioni për përzgjedhjen e Hoteleve për pjesëmarrësit e grupit të parë të Trajnimit për Liderët sindikal.

Me 20.10.2014 është mbajtur komisioni për përzgjedhjen e ofertave për transport në Shqipëri për pjesëmarrësit në Trajnim.

Me 20.10.2014 është mbajtur komisioni për përzgjedhjen e ofertave për akomodimin e pjesëmarrësve në trajnim.

11. Aktivitete të realizuar nga FSSHK-ja në komisione, projektligje në bashkëpunim me MSh-së dhe institucioneve shëndetësore :

Me 28 Janar , 13 dhe 19 Shkurt janë realizuar takime pune të Grupit Punues të FSSHK-së dhe Grupit Punës të Ministrisë së Shëndetësisë për rrezikshmëri, në këtë takim morën pjesë si Kryesues i grupit nga ana e FSSHK-së nënkryetari Blerim Delija, gjatë këtyre takimeve u punua rreth nxjerrjes së kostos financiare për Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me pagesën e përqindjes për rrezikshmëri.

Me 05.03.2014 Me ftesë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës , Kryetari i FSSHK-së ka marrë pjesë në dëgjimin publik për Projektligjin për Sigurimin Shëndetësor .

Me datë 11 Nëntor 2014, Zyrtarja financiare e FSSHK-së ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga MSH me temën “Monitorimin e ekzekutimit të buxhetit dhe reformat e vazhdueshme të sektorit “.

Me 07.08.2014 Është mbajtur Komisioni pranë SHSKUK-së i cili ka mbikqyrur procesin e testimit me shkrim për kandidatët për drejtorë të klinikave.

Me 07.08.2014 Është mbajtur Komisioni i cili ka monitoruar procesin e intervistës me gojë për kandidatët për drejtorë të klinikave.

Me datë 17.09.2014 Është mbajtur Komisioni me gojë për kandidatët për Drejtorë Rajonal të Spitaleve, nga Federata në cilësinë e monitoruesit kanë marrë pjesë Nënkryetari i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe dr. Islam Krasniqi.

Me datë 19.12.2014 është mbajtur takimi i parë i grupit punues për harmonizimin erregulloreve të brendshme të SHSKUK-së si dhe nxjerrjen e rregulloreve të reja përputhje me Statutin e SHSKUK-së.

12. Disa aktivitete të realizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me strukturat politike:

Me 13.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Prishtinës Z.Shpend Ahmeti dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 14.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Prizrenit Z. Ramadan Mujën dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 14.01.2014 Delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka realizuar takime me Përfaqësues të Ministrisë së Administratës Publike dhe Përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë.

Me 14.01.2014 Delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka realizuar takime me Përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë.

Me 15.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Ferizajt Z.Muharem Sfarqa dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 16.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Gjilanit Z.Lutfi Haziri dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 16.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Asacioneve të Komunën Z.Naim Ismajli dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 17.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Mitrovicës Z.Agim Bahtiri dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 22.01.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Pejës Z. Gazmend Muhaxheri, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 04.02.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është realizuar takime me Kryetarin e Komunën së Drenasit Z. Nexhat Demaku dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me 04.02.2014 Me kërkesë të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Syla delegacion i lart i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka realizuar takime me Kryetaren e Komunën së Gjakovës Znj. Mimoza Kusari Lila dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në të gjitha takimet prezent ishin edhe Drejtorët e Drejtorateve për Shëndetësi,gjatë takimeve Kryetari i FSSHK-së prezantoi aktivitetet e FSSHK konkretisht aktivitetet për përmirësimin e infrastukturës ligjore të punëtorëve shëndetësor me theks të veçantë në kujdesin parësor.

Kryetari i FSSHK-së kërkoi nga Kryetarët e Komunave që të përkushtohen maksimalisht me qëllim që Kujdesi parësor shëndetsor të përfitojë sa më shumë të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurime shëndetësore duke marrë parasysh se ky institucion është i obliguar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë të ofrojë rreth 85% të shërbimeve shëndetësore për popullatën e gjerë.

Gjithashtu Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla kërkoi që Komunitat të ngrisin zërin e tyre në Asociacionin e Komunave të Kosovës,ngase me Ligjin për Shëndetësi konkretisht me formimin e Bordit të SHSKUK-së anëtarë të Bordit do të jenë edhe përfaqësuesit e Kujdesit parësor në nivel Komune si dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit për Sigurime Shëndetësore Bordi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të ketë anëtar nga kujdesi parësor shëndetësor i deleguar nga Asociacioni i Komunave.

Kryetari i FSSHK-së kërkoi nga Kryetarët e Komunave të respektohet Kontrata Kolektive Sektoriale e nëshkruar në mes të FSSHK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë si dhe të zhvillohet bashkëpunimi në mes të Sindikatës dhe menaxhmenteve të QKMF-ve dhe Drejtorateve për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetarët e komunave u zotuan se do kërkesat e parashtruara nga FSSHK-ja e të cilat kanë për qëllim ruajtje,zhvillimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe përfaqësimin e saj në nivel vendi por edhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunimin e mirëfillt Sindikatë dhe Menaxhment.

Me 03.03.2014 Një delegacion nga Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës kanë pritur Deputetin nga Lëvizja Vetëvendosje Dr.Faton Topallin dhe zyrtarin ligjor të Lëvizjes së Vetëvendosje.

Me 10.03.2014 Kryetari i FSSHK-së ka realizuar takime me Kryeministrin e Republikës së Kosovës Z.Hashim Thaqi në lidhje me negocimin e rritjes së pagës për punëtorët shëndetësor.

Me 11.03.2014 Një delegacion i FSSHK-së ka realizuar takime me Kryeministrin e Kosovës Z.Hashim Thaqin në të cilin takim është nënshkruar Vendimi për rritje të pagave prej 25% për të gjithë punëtorët në sektorin publik përfshirë edhe punëotrët shëndetësor.

Me datë 15.09.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja ligjore e FSSHK-së kanë realizuar takim me Kryeinspektorin e Kosovës z.Basri Ibrahimimi në lidhje me forcimin e bashkëpunimit në mes të FSSHK-së respektivisht Zyreve Regjionale si dhe Inspektoratit të Punës në nivel të Komunave.

Me datë 15 Dhjetor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla ka realizuar takim me deputetën e Time Kadrijaj me të cilën diskutuan në lidhje me porjektbuxhetin për vitin 2015 me theks të veçantë për buxhetin e shëndetësisë,deputetja kërkoi që të bëhet një analizë financiare mbi projektin për shëndetësi në mënyrë që të diskutojë në mbledhjen e rradhës së Parlamentit të Kosovës.

Me datë 15 Dhejtor 2014 Nënkryetari i FSSHK- së z. Blerim Delija priti në takim deputeten Teuta Haxhiu me të cilën diskutoi mbi Kontratën Kolektive të Përgjithshme respektivisht ftujen e përvojës në punë me projektbuxhet të këtij viti si dhe mori përkrahjen nga deputetja se do të jetë zë i fuqishëm i Sindikatës kurdo që ka nevojë dhe kur është në interes të punëtorëve shëndetësor dhe mbarë popullatës .

13.Disa aktivitete të FSSHK-së me Organizatat Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare :

Me 20.03.2014 Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët të Sindikatave me temën "Roli i sindikatave në përbërjen e re të KES-it"në Hotel Prishtinë.

Me 05.04. 2014 Një delegacion nga FSSHK-së i kryesuar nga Kryetari i FSSHK Dr. Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takim Sekretarin e Përgjithshëm të ETUC Z.Peter Sejdenik me bashkëpunëtorë dhe përfaqësuesi nga Fes

Z.Alush Berisha. Gjatë takim u biseduar lidhur me gjendjen e krijuar në BSPK, reformimin e BSPK-së e shume çështje tjera .

Me 29.04.2014 Delegacion i lartë i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka realizuar takim me K-for,takimi u zhvilluan në vazhden e takimeve të rregullta në të cilën diskutohet rreth gjendej së përgjithshme në shëndetësi.

Me datë 19.06.2014 Kryetari Fssshk-së Dr.Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takim përfaqësuesit nga FES dhe përfaqësuesi nga ETUC me të cilin kanë diskutuar gjetjen e modaliteteve për reformimin e BSPK-së.

Me 11.07.2014 Nënkryetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija dhe Kryetari i Këshillit Drejtues Dr. Jahir Lajqi ka marrë pjesë në tryezë diskutimi me temën “Sindikatat dhe siguria e punëtorëve të pastrimit” në Hotel Prishtina të organizuar nga FES.

Me 16.07.2014 Kryetari i FSSHK-së Dr. Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takim një delegacionin të organizatës joqeveritare “Iniciativa kosovare për stabilitet”.

Me 21.07.2014 Nënkryetar i Federatës Z.Blerim Delija priti në takim përfaqësuesin e FES-it Z.Alush Sejdiun dhe përfaqësuesin nga ETUC ne Kosovë Z. Maliq Brahimi.

Me 25.07.2014 Nënkryetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga BSPK-ja me temën “Shtrejtimi i energjisë elektrike në Kosovë” në Hotel Grand.

Me 01.08.2014 Nënkryetari i FSSHK-së z.Blerim Delija dhe Kryetari i Këshillit Drejtuesi të FSSHK-së Dr. Jahir Lajqi kanë marrë pjesë në takim me përfaqësuesit e FES-it Z.Alush Sejdiun.

Me 15.08.2014 Nënkryetar i Federatës Z.Blerim Delija pritur në takim përfaqësuesin e FES-it Z.Alush Sejdiun dhe përfaqësuesin nga ETUC për Kosovë Z. Maliq Brahimi.

Me datë 23. 09.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla ka pritur në takim delegacionin e Komisionit Ekonomiko-Social Evropian z.Jonathan Peel me të cilin kanë diskutuar në lidhje me gjendjen e përgjithshme të Sindikatave,KES-in si dhe përmbushjes së rekomandimeve të dalura në raportin e KES Evropian.

Me datë 24.09.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla ka marrë pjesë në debatin publik të shoqërisë civile të organizuar nga Komisioni Ekonomiko Social -Evropian në “Hotel Sirius”,ku u shpalua Raporti i KES-it të Evropës dhe në debat u cek se FSSHK duhet të mirret si model për Sindikatat në Kosovë.

Me datë 01.10.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i FSSHK-së z.Blerim Delija kanë realizuar takime me përfaqësuesit e FES-it.

Me datë 15 Tetor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija kanë realizuar takim me delegacionin nga Komisioni Evropian në zyre të Bashkimit Evropian në Kosovës.

Me datë 31.10.2014 Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja ligjore e FSSHK-së kanë realizuar një takime me përfaqësuesit e organizatës “IKS” në Zyrën Qëndrore të FSSHK-së.

Me datë 12 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federata z. Blerim Delija kanë realizuar takime me përfaqësuesit e “Solidar Suisse”.

Me datë 13 Nëntor 2014 Disa zyrtar ligjor të zyrave regjionale kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga IKS me temën “Zhvillimi i Produkteve dhe Shërbimeve për Anëtarë.

Me datë 15 Nëntor 2014 Kryetar i FSSHK-së dr. Blerim Syla me ftesë të Kryetarit të Shoqatës së Asociacioni të sëmuarëve nga diabeti -Gjakovë (ASDGJ) DR. Luan Gola me rastin e kremtimit të ditës ndërkombëtare të diabetit 2014.

Me datë 18 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federatës Z.Blerim Delija ka zhvilluar takime me Përfaqësuesit e “IKS”-it lidhur me aprovimin e projektit për trajnimin e Forumit Rinor të FSSHK-së.

Me datë 18 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federatës Z.Blerim Delija ka marrë pjesë në sesionet informuese për projekte “Provimi i shoqërisë Demokratike” në Kosovës për periudhën 2014-2018 nga KCSF-ja.

Me 02.12. 2014 Një delegacion nga FSSHK-së i kryesuar nga Kryetari i FSSHK Dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i FSSHK-së Z.Blerim Delija kanë pritur në takime Sekretarin e Përgjithshëm të ETUC Z.Peter Sejdenik dhe Përfaqësuesit nga Fes Z.Alush Berisha. Gjatë takim u biseduar lidhur me gjendjen e krijuar dhe reformimi i BSPK, mundësia e kyçjeve të Sindikata, e shume çështje tjerat .

14. Aktivitetet e FSSHK-së me sindikatat vendore:

Me 26.02.2014 Delegacion i lartë i Fsshk-së i përbërë nga Kryetari i FSSHK-së Dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i Fsshk-së Z.Blerim Delija kanë realizuar takime të përbashkët me Kryetarët e Sindikatavë të Kosovës si si Kryetari e Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK) ,Z.Izet Mustafa Sindikatën e Policisë të Kosovës (SPK), Z.Shaban Tasholli, Sindikata e Administratës të Kosovës (SPA), Z.Ndue Kalaj, Sindikata e Pavarur e Ekonomisë së Vogël dhe Zejtarisë së Kosovës (SPEVZ) Z.Jusuf Azemi.

Me datë 22.10.2014 Është realizuar një takime i përbashkët në mes të tri sindikatave të Kosovës SBASHK-u, SPK dhe FSSHK-së dhe përfaqësuesi nga Fes-i .

Me datë 29.10.2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla ka nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit , Bashkëveprimit dhe Përfaqësimit në mes të Sindikatave SBASHK-u, SPK dhe FSSHK-së.

Me datë 12 Dhjetor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK- së z. Blerim Delija kanë realizuar një takime me Përfaqësuesin e Sindikatës së arsimit,policisë,administratës dhe juridikaturës me ç’rast kanë dal më një komunikatë për media duke shprehur qëndrimin e Sindikatës së arsimit, shëndetësisë, policisë,juridikaturës.

Me datë 16 Dhjetor 2014 Është organizuar Konferencë për media nga Sindikata e shëndetësisë, arsimit, policisë , dhe administratës lidhur me vendimin e Qeverisë për mos ngritjen e pagave me ç’rast sindikatat dulën me kërkesat e tyre.

Me datë 19 Dhjetor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkryetari i FSSHK- së z. Blerim Delija dhe Kryetarët e Sindikata e Policisë, Sindikata e Arsimit dhe Sindikata e Administratës kanë realizuar takime me shefin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes së Vetëvendosje dhe shefen e Grupit Parlamentar të AAK-së znj. Donika Kada Bujupi.

Me datë 22 Dhjetor 2014 Delegacioni nga Sindikata e Kosovës i përbërë nga Sindikatat të Shëndetësisë , Sindikata e Policisë, Sindikata e Arsimit dhe Sindikata e Administratës kanë realizuar takime me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së seli në Kuvendit të Kosovës.

Me datë 23 Dhjetor 2014 Delegacioni nga Sindikata e Kosovës i përbërë nga Sindikatat të Shëndetësisë , Sindikata e Policisë, Sindikata e Arsimit dhe Sindikata e Administratës kanë realizuar takime me shefin e Grupit Parlamentar të Nisma për Kosovën në seli në Kuvendit të Kosovës.

Me datë 24 Dhjetor 2014 Delegacioni nga Sindikata e Kosovës i përbërë nga Sindikatat të Shëndetësisë , Sindikata e Policisë, Sindikata e Arsimit dhe Sindikata e Administratës kanë realizuar takime me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së në seli në Kuvendit të Kosovës.

15. Aktivitetet me subjektet afariste për përfitim të beneficioneve shtesë për anëtarësinë e gjerë:

Në kuandër të aktiviteteve për arritjen e marrëveshjeve mbi përfitimin e beneficioneve për anëtarësinë e gjerë të FSSHK-së nga subjektet afariste të cilat ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme,Federata respektivisht Nënkryetari Blerim Delija ka zhvilluar një

sërë takimesh me Kompani dhe subjekte të tjera afarsite me qëllim të dakordimit rreth zbritjeve të mundshme në qmim për antarët e FSSHK-së të pajisur me kartela të anëtarësisë.

Në një kohë të shkurtër janë zhvilluar këto takime:

Me datë 12.09.2014 Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija dhe zyrtarja financiare e FSSHK-së kanë realizuar një takim me drejtoreshën e Bankës Ekonomike Znj. Merita Peja.

Me datë 18.09.2014 Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija ka pritur në takime zëvendës drejtorin e bankës ekonomike z. Dren Krypa dhe koordinatorin e degës Anduen Canaj.

Me datë 03.10.2014 Nënkyetar i FSSHK-së z. Blerim Delija , zyrtarë financiare dhe zyrtaren ligjore të FSSHK-së kanë realizuar takim me një delegacion me përfaqësuesit nga Banka Ekonomike në Zyrë Qëndrore të FSSHK-së.

Me datë 10 Nëntor , Nënkyetari i Federatës z. Blerim Delija kanë realizuar takime me menaxherin e Petrol Companisë z. Sokol Muja.

Me datë 10 Nëntor , Nënkyetari i Federata z. Blerim Delija kanë realizuar takime me Koordinatorin e shitjes të kompanisë “ Kujtesës” z. Enver Berisha.

Me datë 13 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federata z. Blerim Delija ka realizuar takime me Përfaqësuesit e IPKO-së.

Me datë 18 Nëntor 2014 Nënkyetari i Federatës Z.Blerim Delija ka marë pjesë në takimin me përfaqësues nga “IPKO”.

Me datë 20 Nëntor 2014 Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla dhe Nënkyetari i Fsshk-së z. Blerim Delija kanë zhvilluar një takime me menaxhmenti ne Petrol Companys z. Sokol Muja.

Me datë 25 Nëntor 2014 Nënkyetari i Fsshk-së z. Blerim Delija kanë zhvilluar një takime me drejtorin financiar te Al- Petrol z. Tahir Zogaj.

Me datë 05 Dhjetor 2014 Kryetari i Fsshk-së dr. Blerim Syla dhe nënkyetari Blerim Delija ka realizuar një takime me menaxherin e Petrol Companisë z. Sokol Muja, në Zyrën Qëndrore të FSSHK-së.

Me datë 17 Dhjetor 2014 Nënkyetari i FSSHK-së ka realizuar takim me pronarin e Kompanisë Euro Goma,me të cilin pas bisedimeve ka nënshkruar marrëveshjen me zbritje prej 25% në të gjitha produktet e Kompanisë për antarët e FSSHK-së të pajisur me Kartela.

Pas të gjitha takimeve vlen të theksohet se në nivel të Regjioneve janë arritur marrëveshje në pothuajse të gjitha Regjionet Sindikale dhe anëtarësia e gjerë ka filluar ti gëzojë këto beneficone.

Janë arritur marrëveshje me Kompani vendore ushqimore, veshëmbathje, higjienë, mobileri, derivate, etj.

Së fundmi është arritur marrëveshja me Petrol Company me Vendim të Kryesisë duke marrë parasysh se kanë qenë të propozuara dy oferta dhe Kryesia ka vendosur për Petrol Company e cila ka ofruara zbritje prej 0,0025 cent per litër në derivate.

16. Aktivitetet e FSSHK-së në lidhje me zgjedhjet sindikale:

Me 11.02.2014 Është mbajtur kuvendi zgjedhor në QKMF të Istogut dhe janë zgjedhur strukturat udhëheqëse të Sindikatës së QKMF në Istog. Me ç'rast është zgjedhur Kryetarë i Sindikatës së QKMF Istog është zgjedhur Z. Shaban Bajraktari.

Me 11.06.2014 Janë mbajtur zgjedhjet për Përfaqësues të Sindikatës së Spitalit Rajonal të Gjilanit. Me ç'rast është zgjedhur Kryetar i Sindikatës së Spitalit Rajonal të Gjilanit Dr. Begush Canaj.

Me datë 18.06.2014 Janë mbajtur zgjedhjet për struktura udhëheqëse të Sindikatës së QKMF-Kaçanikut ku me shumicë votash është zgjedhur Kryetar i Sindikatës z. Hamdi Dullovi si dhe Kryetar i Sindikatës së QKMF -Hanit të Elezit është zgjedhur Ibush Suma.

Me datë 04 Nëntor 2014 Janë organizuar zgjedhjet për Kryetar dhe Nënkyetar të sindikatës në QKMF në Kamenicë i gjithë procesi i zgjedhjeve është monitoruar nga Nënkyetari i FSSHK-së Blerim Delija si dhe Përfaqësuesi i Regjionit Sindikal të Gjilanit Dr. Naim Sahiti. Nga këto zgjedhje me shumicë votash për Kryetar u votua Besim Beqiri si dhe nënkryetari Fisnik Shala.

Me datë 26 Dhjetor 2014 Janë mbajtur zgjedhjet për Kryetar të Sindikatës së QKMF në Gjakovë, ku ka marrë pjesë Nënkyetari i FSSHK-së z. Blerim Delija në cilësinë e monitoruesit të zgjedhjeve. Kryetari i QKMF-Gjakovë u zgjodhë Dr. Genc Shtrezi, si dhe dy nënkryetarët Artan Hoxha dhe Mirlinda Morina.

17. Aktivitetet të tjera :

Përgjatë vitit 2014 FSSHK gjithashtu ka publikuar 7 (shtatë) Tribuna të cilat 6 (gjashtë) prej tyre janë publikuar në Gjuhë Shqipe dhe 1 (një) në Gjuhën Angleze e cila është përgatitur

enkas për Konferencën mbi migrimin e punëtarëve të cilën FSSHK e ka realizuar në Qershor të 2014,në këtë Tribunë janë përfshirë rezultatet e pyetësorit si dhe përmbledhja e aktiviteteve të zhvilluara përgjatë Konferencës Rajonale,si dhe në fund fjalimi përmbyllës i Kryetarit.

Një aktivitet tjetër me rëndësi është shpërndarja e kartelave të anëtarësisë e cilë është mundësuar falë përkrahjes së organizatës IKS e financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit Përkrahja e partenrëve social,nga muaji Korrik e deri në fund të vitit 2014 janë regjistruar në databazë që nënkupton janë pajisur me kartela 72% e anëtarësisë së gjerë të FSSHK-së të cilët me anë të kartelave kanë filluar të përfitojnë nga marrëveshjet e nënshkruara me subjektet afariste

Prishtinë,Janar 2015

Raportin e punuan:

Nora Murataj&Yllka Krasniqi